

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 7688 Rep.

Nr. 1899 Kol.



AKT-THEMELIMI

Ne Tirane, sot me date 20. 12. 2012 (dymije e dymbedhjte), ne Zyren e Noterise Rr "Sulejman Delvina", perpara meje noteres **Majlinda Lleshi**, anetare e dhomes se notereve Tirane, u paraqit personalisht, shtetasi:

KREU I

Neni 1

Krijimi

1. **Qendra "Zhvillim dhe Integrim për Shqipërinë"**, regjistruar si person juridik me vendimin Nr.763 datë 18.10.2012, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar me prokurë të përgjithshme me Nr.6206 Rep. dhe 1492 Kol. datë 01.10.2012, nga Av.Denisa Daka,
2. **Komuna Cakran, Fier**, përfaqësuar nga Kryetari i saj Z. Vladimir Korçari, i biri i Bules dhe i Tekiut, lindur më 28/11/1959 në Cakran dhe banues në Cakran, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me kartën e identitetit, Nr. 025661239.
dhe
3. **Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Cakran 2012" shpk**, me Nr.Nipti L22407018U, e regjistruar me datë 07.12.2012 në QKR, përfaqësuar, nga Av.Denisa Daka, me prokurë të përgjithshme Nr.7720 Rep dhe 1802 kol, datë 24.11.2012, Notere Majlinda Lleshi.

Kane vendosur krijimin e SHOQËRISË AKSIONERE "GURËZEZË" SH.A. me termat e më poshtme.

Neni 2

Forma juridike

Në mbështetje të vullnetit të aksionerëve themelues të shprehur në aktin e themelimit si dhe në pajtimt të plotë me dispozitat e Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", themelohet Shoqëria tregtare "GURËZEZË" SH.A., e cila do të funksionojë sipas dispozitave të Aktit të Themelimit dhe këtij Statuti.



Neni 3

Selia

Selia dhe Zyrat e Përfaqësimit

Selia e Shoqërisë do të jetë në Tirane, Rr."Durrësit", Pallati "Karavan" Laprake.

Veprimtaria e shoqërisë në tërë territorin e Republikës së Shqipërisë kryhet nga degët e saj, të cilat funksionojnë në rrethe apo në ndarje të tjera administrative të Republikës së Shqipërisë nën drejtimin e Administratorit të saj.

Shoqëria mund të çelë degë dhe zyra përfaqësimi të reja jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Zyrat mund të krijohen apo të mbyllen me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë:

Menaxhim, mirëmbajtje dhe riprodhim i pyjeve duke përfshirë edhe tregtine e lëndës së drurit, fidane dhe të gjithë nënproduktet veprimtari bujqesore dhe blegtorale, punishte të përpunimit të produkteve bujqesore dhe blegtorale, impianti i vaditjes, rezervat gjatë dhe riprodhim i kafsheve dhe shpendeve të egra. Prodhim energjie, import eksport, ndertime industriale, civile, rrugore, germime arkeologjike. Nxjerrje dhe përpunim inerte. Aktivitet turistik.


Shoqëria, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, do të kryej çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtëpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj.

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit Tirane.

Aksionerët e Shoqërisë mund të vendosin kufizimin e afatit të veprimtarisë dhe më pas zgjatjen e tij një apo disa herë, sipas një vendimi të posaçëm



KREU II

KAPITALI
Neni 6

KAPITALI THEMELTAR

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 3.500.000 leke (tremilion e peseqindmije leke).

Ai eshte i ndare ne 1000 aksione te se njejtës kategori me vlere nominale prej 3500 leke per cdo aksion te shlyer per teresine e vleres nominale te tyre.

Aksionet jane te numertuara nga 1 deri ne 1000 aksione.

Aksioneret themelues te Shoqerise tregtare "Gurezeze" sha, zoterojne aksionet ne kete shoqeri, si me poshte:

1.Qendra "Per zhvillim dhe integrim per Shqiperine":

5% te vleres se aksioneve ne kapitalin themeltar te Shoqerise te barabarte me 5 numer aksionesh me vlere:

175.000 leke ose 50 Aksione.

2.Komuna Cakran:

5% te vleres se aksioneve ne kapitalin themeltar te Shoqerise te barabarte me 5 numer aksionesh me vlere:

175.000 leke ose 50 aksione

3.Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "Cakran 2012" shpk

90% te vleres se aksioneve ne kapitalin themeltar te shoqerise te barabarte me 90 numer aksionesh me vlere:

3.150.000 leke ose 900 aksione.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

ORGANET E SHOQERISE

SEKSIONI I

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

Neni 7

Mbledhjet e Asamblese dhe efektet detyruese te vendimeve.

Te drejtat e aksionereve, per ceshtje te lidhura me veprimtarine e funksionimit te shoqerise ushtrohen nepermjet Asamblese se Pergjithshme.

Cdo Asamble e mbledhur konform ligjit, perfaqeson teresine e aksioneve te zoteruara nga aksioneret.

Neni 8

Te drejtat dhe detyrimet e Asamblese se Pergjithshme

[Two handwritten signatures]

[Official stamp of the Municipality of Cakran, Republic of Albania, with a handwritten signature over it]

Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështje të percaktuara si më poshtë :

- përcaktimin e politikave tregtare;
- ndryshime në statut;
- emërtimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës;
- emërtimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar ;
- miratimin e skemës së shpërblimeve për anëtarët e Këshillit Mbikqyrës , Administratorit, likujduesit, ekspertët kontabël të autorizuar;
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore;
- shpërndarjen e fitimeve vjetore;
- zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
- pjestimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;
- ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksionë të llojeve e kategorive të veçanta ;
- riorganizimi dhe prishja e Shoqërisë;
- miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të saj;
- çështje të tjera të parashikuara në ligj dhe statut.
- Marrja e vendimeve

- Asambleja e Përgjithshme vendos me tre të katërtat e votave të aksionerëve, që marrin pjesë në votim në lidhje me ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë. Për çështjet e tjera Asambleja e përgjithshme merr vendime me shumicën e voteve të aksionerëve pjesëmarrës.

- NENI 9

- Mënyra e votimit

- Asambleja e Përgjithshme merr vendimet nëpërmjet votimit të hapur për emërtimin dhe shkarkimin e Anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës . Asambleja e Përgjithshme vendos me votim të fshehtë, nese kjo mënyrë kërkohet nga Aksionerët që zotërojnë një numër aksionesh që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit të regjistruar të Shoqërise.

- NENI 10

- Vënia në dispozicion të Aksionerit të dokumenteve dhe informacioneve

- Shoqëria mban dhe vë në dispozicion të Aksionerit, në kushtet dhe në afatet e parashikuara nga ligji, raportet, dokumentet dhe llogaritë vjetore që shqyrton Asambleja. Me perjashtim të inventareve dhe të ndonjë dokumentacioni tjetër të caktuar nga



Asambleja, dokumentet që duhet ti vihen në dispozicion Aksionerit i dërgohen këtij bashkë me njoftim-thirrjen për mbledhje.

- SEKSIONI 2
- KËSHILLI MBIKQYRËS

- NENI 11
- Përbërja dhe emërtimi
-
- Këshilli mbikqyrës kryen funksion mbikqyrës për të gjithë veprimtarinë e Shoqërisë.
- Këshilli mbikqyrës përbëhet nga tre deri në 21 anëtarë të cilët nuk mund të jenë dhe Administratorë të Shoqërisë. Ata zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e votave të aksionerëve që marrin pjesë.
- Aksionerët e shoqërisë kanë të drejtë të përzgjedhin secili nga 1 (një) anëtar në përbërjen e Këshillit Mbikqyrës,
- Anëtarët e parë të Këshillit Mbikqyrës do të jenë 3 (tre) në numër, si me poshtë vijon:
 - 1. Mariel Xhemali
 - 2. Vladimir Korcari
 - 3. Kastriot Zeraj
- Kohëzgjatja e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës do të jetë tre vjet, Ata kanë të drejtë të rizgjidhen.
- të cilët kanë pranuar detyrën.
- Kohëzgjatja e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës do të jetë tre vjet, Ata kanë të drejtë të rizgjidhen.
- Këshilli Mbikqyrës, në përbërjen e tij ka një kryetar dhe një zëvendëskryetar që ngarkohen me organizimin dhe zhvillimin e mbledhjeve të Këshillit. Ata ushtrojnë funksionet e tyre gjatë tërë periudhës së mandatit të dhënë.
- Kryetar i Këshillit mbikqyrës është zgjedhur zoti Kastriot Zeraj.

NENI 12

Personi Juridik, Anetar i keshillit Mbikqyres.

Një person juridik që është Aksioner i Shoqërisë nuk mund të jetë Anëtarë i Këshillit Mbikqyrës. Ata janë individë të cilët duhet të jenë të pavarur dhe të ndryshëm nga Administratori i Shoqërisë.

NENI 13

Administratorët

Administratorët drejtojnë dhe administrojnë shoqërinë dhe marrin vendime për mënyrën e vënies në zbatim të politikave tregtare.

Administratori i parë i Përgjithshëm është Z.Erjon Xhemali.

NENI 14

Emërimi dhe shkarkimi

Administratorë të shoqërisë mund të jenë një ose disa persona fizik. Ata emërohen nga Këshilli Mbikqyrës për një afat të përcaktuar në statut, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se tre vjet. Ata mund të rizgjidhen.

Administratori i një shoqërie mëmë nuk mund të zgjidhet si Administrator i një shoqërie të kontrolluar dhe anasjelltas.

Administratori i një shoqërie nuk mund të jetë kryetar i Këshillit Mbikqyrës të një shoqërie të kontrolluar dhe anasjelltas

Këshilli Mbikqyrës ka të drejtë të shkarkojë administratorët në çdo kohë.

NENI 15

Të drejtat dhe përgjegjësitë

Administratorët kanë të drejtë dhe detyrohen:

- Të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
- Të përfaqësojnë shoqërinë tregtare tek te tretet.
- Të kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe librave kontabël të shoqërisë;
- Të përgatisin dhe të nënshruajnë bilacin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilët ia paraqesin Këshillit Mbikqyrës për miratim, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, më pas për miratimin Asamblese se përgjithshme;
- Të krijojnë një sistem monitoimi e njoftimi për rrethanat, që mund të kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë;
- Të kryej regjistrimet dhe publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashikimeve të këtij ligji apo të ligjeve të tjera;
- Të raportojnë përpara Këshillit Mbikqyrës për zbatimin e politikave tregtare dhe realizimin e vendimeve me rëndësi të veçantë, për veprimtarinë e shoqërisë;
- Të kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut;

Administratorët duhet të informojnë menjëherë kryetarin e këshillit mbikqyrës në rastet kur; sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare rezulton apo parashikohet se humbjet arrijnë në një vlerë të barabartë me 50% të kapitalit ose që aktivet e shoqërisë nuk mbulojnë detyrime që janë të kërkueshme brenda 3 muajve në vijim. Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë aktive të cilat kanë një vlerë me të lartë se 5% të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara. brenda 2 viteve të para pas regjistrimit, Te drejten e blerjes së aksioneve e ka fillimisht një nga aksioneret e shoqërisë, në rast shitje të tyre, i cili ka në shoqëri aksione me vlerë më të lartë se 5% e aseteve të shoqërisë.

NENI 16

[Signature] *[Signature]*

Përfaqësimi i shoqërisë

Administratorët përfaqësojnë shoqërinë në lidhje me të tretët. Administratorët të cilët kanë të drejtë të përfaqësojnë shoqërinë tregtare në mënyrë të përbashkët, mund të autorizojnë disa prej tyre për kryerjen e disa veprimeve të caktuara.

Tagrat e përfaqësimit të administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre regjistrohen pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

NENI 17

Detyrime dhe përgjegjësi të përbashkëta të Këshillit Mbikqyrës dhe Administratorëve

Administratorët dhe anëtarët e Këshillit Mbikqyrës detyrohen:

- të kryejnë detyrat e tyre në mirëbesim e në interesin e shoqërisë;
- të ushtrojnë kompetencat që u jep ligji dhe statuti;
- të vlerësojnë në mënyrë të përshtatshme çështjet për të cilat merret vendim
- të parandalojnë dhe të mënjanojnë rastet e konfliktit, të pranishme apo të mundëshme, të interesave personale me ato të shoqërisë;
- të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm

Ata përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim gjatë kryerjes së detyrave të tyre. Ata përgjigjen në mënyrë solidare për vërtetësinë e të gjitha pasqyrave financiare, të publikimeve të detyrueshme dhe informacioneve të tjera kryesore të veprimtarisë së shoqërisë.

NENI 18

Mbikqyrja e veçantë


Aksionerët të cilët përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit bazë ose një përqindje më të vogël të parashikuar në statut apo kreditorët e shoqërisë, pretendimet e të cilëve ndaj saj janë të paktën 5% të kapitalit të regjistruar, mund ti kërkojnë Këshillit Mbikqyrës të kryej mbikqyrje të veçantë për çështje të posaçme sidomos kur merret në shqyrtim ligjshmëria e veprimeve të administratorëve.

KAPITULLI IV EKSPERTËT KONTABËL

NENI 19

Emërimi dhe shpërblimi

Asambleja e Përgjithshme ka të drejtën për të caktuar një ose disa ekspert kontabël të zgjedhur nga listat e Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar.



Në caktimin e ekspertëve mbahen parasysh përjashtimet dhe papajtueshmëritë e parashikuara në rregullat e posaçme. Ekspertët kontabël caktohen për një kohë që i përgjigjet një ushtrimi financiar. Ata janë të ricaktueshëm.

Shpërblimi i ekspertëve kontabël të autorizuar caktohet nga Asambleja e Përgjithshme dhe përballohet nga shoqëria.

Shoqëria Tregtare "GURËZEZË" SH.A. do të ketë 1 (një) ekspert kontabël, i cili do të jetë Z. BUJAR RAMI, me detyrë Ekspert Kontabël i Autorizuar me licensë me numër 90, datë 10/01/2001, mbajtës i letër-njoftimit elektronik me nr. 029807158.

NENI 20

Detyrat dhe të drejtat

Detyrat dhe të drejtat e ekspertëve kontabël të autorizuar të shoqërisë janë ato të parashikuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

Asambleja e Përgjithshme mund t'u kërkojë ekspertëve kontabël të autorizuar kryerjen e kontrolleve apo verifikimeve të posaçme për çeshtje me interes të shoqërisë, me marrjen e raportit të ekspertëve kontabël të autorizuar asambleja miraton raportin dhe bilancin e shoqërisë. Raportet që ata përgatisin depozitohen në selinë e shoqërisë, në afatet e parashikuara nga ligji.

KAPITULLI V LLOGARITË VJETORE, ÇAKTIMI I REZULTATIT

NENI 21

Viti financiar

Shoqëria përgatit çdo vit financiar llogaritë vjetore në pajtim me ligjin për kontabilitetin.

Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhejtor të çdo viti.

NENI 22

Caktimi i rezultateve

Rezultati i vitit financiar nxirret dhe caktohet në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe mbas dhënies së raportit përfundimtar nga ekspertët kontabël të autorizuar.

NENI 23

Fitimet dhe fondit rezervës

Fitime që rezultojnë nga bilanci ushtrimor do të shpërndahen sipas një vendimi përkatës të Asamblesë nëpërmjet aksionerëve pasi të jenë zbritur nga kjo shumë taksat dhe tatimet sipas ligjit, vlera e humbjeve të pësura

gjatë vitit ushtrimor paraardhës si dhe 5% (pesë për qind) që destinohet për fondet e rezervës së domosdoshme, derisa kjo të ketë arritur nivelin maksimal prej 1/10 e kapitalit themeltar.

Aksionerët mund të vendosin sipas ligjit për një destinim të ndryshëm të fitimit të pashpërndarë. Me vendimin e miratimit të bilancit ushtrimor, Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë t'i destinojë fitimet që i takojnë ortakëve në formë dividendi për zmadhim të kapitalit themeltar, investime ose mbartje, etj.

KAPITULLI VI PRISHJA, LIKUJDIMI, KUNDËRSHTIMET

NENI 24

Prishja, likuidimi

Shoqëria aksionere priset:

- kur mbaron kohëzgjatja për të cilën është themeluar
- kur merr vendim Asambleja e Përgjithshme
- me hapjen e procedurave të falimentimit
- kur nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit
- me vendim gjykatë.

Shoqëria aksionere likuidohet në dy mënyra, likuidimi i zakonshëm dhe likuidimi i thjeshtëzuar.

Likuidimi i zakonshëm kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Asambleja e Përgjithshme.

Në rast se Asambleja nuk merr vendim për caktimin e likuiduesit ai zgjidhet nga gjykata. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve.

Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjetueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen t'i pezullojnë procedurat e likuidimit dhe t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqëritë aksionere apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.

Pas shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve, likuiduesi u shpërndan ortakëve apo aksionerëve aktivet e mbetura, sipas të drejtave që ato kanë në ndarjen e fitimeve, me përjashtim të rastit kur statuti parashikon rradhë preferenciale.

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çrregjistrimin e shoqërisë.

Për sa i përket likuidimit të thjeshtëzuar ky mund të kryhet nëpërmjet një procedure të përshpejtuar, nëse kjo vendoset nga të gjithë ortakët apo Aksionerët dhe kur këta deklarojnë përpara gjykatës përkatëse se të gjitha detyrimet e shoqërisë ndaj kreditorëve janë shlyer dhe janë rregulluar të gjitha marrëdhëniet me punëmarrësit.

Administratorët njoftojnë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit vendimin për likuidimin e shoqërisë, nëpërmjet procedurës së thjeshtëzuar, gjithashtu ata janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga shkelja e detyrave të tyre gjatë likuidimit të thjeshtë.

NENI 25

Zgjidhja e mosmarrveshjeve

Të gjitha mosmarrveshjet gjatë funksionimit të shoqërisë ose gjatë likuidimit të saj që lindin midis shoqërisë dhe Aksionerit ose midis vetë Aksionerëve, lidhur me veprimtarinë e shoqërisë, i nënshtrohen juridiksionit të gjykatave kompetente në kushtet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

KAPITULLI VII DISPOZITAT E FUNDIT

NENI 26

Nëpunësit, të zgjedhurit nga Organet drejtuese të shoqërisë, dhe personat që punojnë për llogari të saj, mbajnë përgjegjësi penale e civile sipas ligjit përkatës kur me dashje shkelin detyrat e ngarkuara dhe i shkaktojnë humbje Shoqërisë.

NENI 27

Akti Themelimit, hyn në fuqi mbas miratimit dhe regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Gjithçka që nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Akt Themelimi, do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe ligje të tjera të lidhura me të, në fuqi në Republikën e Shqipërisë, në veçanti ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"

NENI 28

Akti I Themelimit të Shoqërisë pasi u lexua nga Aksionerët e Shoqërisë u nënshkrua prej tyre pa vërejtje para Noteres të vendit të themelimit të Shoqërisë. Ky Akt Themelimi, hartohet në katër kopje në gjuhën shqipe.



AKSIONERËT E
SHOQËRISË AKSIONERE
"GURËZEZË" SH.A.

Qendra "Zhvillim dhe Integrim për Shqipërinë"

përfaqësuar nga Av. Denisa Daka,

Denisa Daka

STUDIO LIGJORE

AVOKATE

Komuna Cakran, Fier,

përfaqësuar nga Kryetari,

DENISA DAKA
MOB: 0692065597

Z. Vladimir Korçari

Vladimir Korçari

**Qendra "Për Zhvillim dhe
Integrim për Shqipërinë"**

ZHISI

TIRANË

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Cakran 2012" shpk,

Përfaqësuar nga Av. Denisa Daka

Denisa Daka

STUDIO LIGJORE

AVOKATE

DENISA DAKA
MOB: 0692065597

Shoqëria "CAKRAN 2012" shpk

Kompleksi karavan

Laparak Tiranë

TEL: 06924244535279



Notere Majlinda Lleshi
Dhoma e Notereve Tirane
Rr" Sulejman Delvina "
Tel ++ 2234555
Nr 4220 Rep
Nr 1602 Kol



Sot me date 24.11 2012 (dymije e dymbëdhjete), ne Tirane, pare meje Notere Majlinda Lleshi Anetare e Dhomes se Noterise Tirane me seli ne Rr" Sulejman Delvina" u paraqiten personalisht te perfaqesuarit te cilet kerkoi perpilimin e prokures se pergjitheshme si me poshte vijon :

TE PERFAQESUAR :

Xhezmi VEIZAJ i biri i Ylmiut dhe i Pesenes i datelindjes 20.08.1958 lindur ne Cakran Fier dhe banues ne Fier madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar i pajisur me leternjoftimin ID Nr 027801789,
Kastriot ZERAJ i biri i Behadinit dhe i Faros i datelindjes 15.05.1978 lindur dhe banues ne Vlore madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar i pajisur me pasaporten Nr BG 6656402,

PROKURE E PERGJITHESHME (bazuar ne N.70 , 71 e vijues te K.C.)

"Ne Porositësat Xhezmi Veizaj dhe Kastriot ZeraJ deklarojme se i jap tagër dhe kompetencë të plotë Av. Denisa DAKA, anëtare e Dhomës së Avokatëve Tiranë, me licence nr. 679, dhe NIPT Nr K72227007L, te ciles i japim te drejte dhe kompetence te plote te na përfaqësojë lidhur me krijimin e nje shoqerie tregtare prane QKR duke nenshkruar te gjithë aktet per krijimin e saj prane QKR. Ka te drejte te regjistroje kete shoqeri dhe te ndjeke ecurine e saj prane te gjithë organeve perkatese te regjistrimit. Perfaqesuesja jone ka te drejte te nenshkruaje akt marreveshje dhe cdo lloj akti administrativ lidhur me te. Perfaqesuesja ka te drejte te paraqese dhe terheqe dokumenta ne emrin tone dhe ne emer te shoqerise qe do te krijohet, ne te gjithë organet e Administrates ne Republiken e Shqiperise. Perfaqesuesja jone ka te drejte te na perfaqesojë ne rast se do te jete e nevojshme ne cdo proces gjyqësor ne te gjithë shkallet e gjykimit, ne gjykatat e te gjithë niveleve, ne te cilat mund te jemi padites, te paditur ose persona te trete, ne gjykatat e cdo rrethi gjyqësor. Avokatja ka të drejtë qe cdo në proces gjyqësor, të paraqese kërkesa paraprake, kerkese padi, kunderpadi si dhe të ndërmarre çdo veprim procedural gjyqësor të nevojshëm për zgjidhjen e çështjeve në favorin tone dhe të nënshkruajë aktet e nevojshme procedurale në këto procese në emrin tone. Perfaqesuesja ka të drejtë të paraqese ankim kundra vendimeve te ndermjetme, perfundimtare, rekursi apo kunderekursin në Gjykatën e Lartë si dhe te kete te drejten te paraqese kerkese në Gjykatën Kushtetuese, me te drejte nenshkrimi. Perfaqesuesja ka të drejtë të na përfaqësojë dhe mbrojë edhe në Gjykatën e Apelit, Gjykatën e Lartë apo në Gjykatën Kushtetuese

Kjo prokure u hartua ne kater kopje me fuqi te barabarte ligjore dhe pasi u lexua me ze te larte u gjet sipas vullnetit te lire dhe te plote te te perfaqesuarvet u nenshkrua prej tyre para meje Noteres dhe une duke e gjetur ate ne perputhje me ligjin e vertetoj.

TE PERFAQESUARIT

XHEZMI VEIZAJ

Xhezmi Veizaj
[Signature]

KASTRIOT ZERAJ

Kastriot ZeraJ
[Signature]



Notere Majlinda Lleshi
Dhoma e Notereve Tirane
Rr" Sulejman Delvina "
Tel ++ 2234555
Nr 6206 Rep
Nr 1492 Kol



Sot me date 01.10.2012 (dymije e dymbëdhjete), ne Tirane, pare meje Notere **Majlinda Lleshi**
Anetare e Dhomes se Noterise Tirane me seli ne Rr" Sulejman Delvina" u paraqit personalisht i
perfaqesuari i cili kerkoi perpilimin e prokures se pergjitheshme si me poshte vijon :

I PERFAQESUARI :

ERJON XHEMALI i biri i Njaziut dhe i Hedijes, i datelindjes 14.07.1976, lindur dhe banues ne
Vlore, Nr.10, madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar i pajisur me pashaporten
personale AA2534233,

PROKURE E PERGJITHESHME (bazuar ne N.70 , 71 e vijues te K.C.)


"Une Porositësi, deklaroj se i jap tagër dhe kompetencë të plotë **Av. Denisa DAKA**, anëtare
e **Dhomës së Avokatëve Tiranë**, me licence nr. 679, dhe NIPT Nr K72227007L, te ciles i jap te drejte
dhe kompetence te plote te me përfaqësojë ne rregjistrimin e OJF,SHA, SHPK, perpara gjykatave te
te gjitha niveleve, ne te gjithë territorin e Republikës se Shqiperise, duke redaktuar kerkesa dhe akte
ne emrin tim me te drejte nenshkrimi, duke patur te drejten te terheqe, dhe te nenshkruaje cdo loj
akti ne emrin tim, me organet e pushtetit vendor, ato te pushtetit ekzekutiv, me organet e
administrates qendrore ne te gjithë territorin e Repubulikes se Shqiperise. Av. I jap te drejte te
negocioje e te lidhe cdo marreveshje apo kontrate te te gjitha llojeve, duke i dhene cdo te drejte per te
nenshkruar keto akte ne emrin e OJF,SHA,apo SHPK., ne te cilat une jam themelues, apo aksioner
themelues.

Avokatja ka te drejte te krijojë dege ne te gjithë territorin e Republikës se Shqiperise, apo shoqeri te
cdo lloji anonime apo me pergjegjesi te kufizuar, te redaktojë cdo lloj akti me te drejte nenshkrimi si
dhe te me perfaqesojë ne gjykatat e te gjitha niveleve ne te gjithë territorin e Republikës se
Shqiperise.Av.ka te drejte te marre pjese si perfaqesuese e OJF,apo e SHA si dhe e SHPK, ne cdo
mbledhje apo takom te cdo lloji si perfaqesuese e tyre, duke patur te drejten te nenshkruaje cdo lloj
akti, vendimi, kontrate, apo cdo akt tjetër qe ajo do ta konsiderojë te nevojshem apo te
domosdoshem ne permbushje te qellimit apo te misionit te subjekteve sa siper.Gjithashtu avokatja
ka te drejte te me perfaqesojë ne cdo proces gjyqësor ne te gjithë shkallet e gjykimit, ne te gjithë
territorin e Republikës se Shqiperise, ne te cilat OJF,SHPK,ose SHA mund te jete padites, e paditur
ose person i trete,ne gjykatat e cdo rrethi gjyqësor. Avokatja ka të drejtë qe cdo në proces gjyqësor,
të paraqese kërkesa paraprake, kerkese padi, kunderpadi, të kërkojnë përsëritjen e pjesshme apo të
plotë të hetimit gjyqësor, të paraqese prova, të pyese dëshmitarë, të bëjë mbrojtjen, të jape
shpjegimet e nevojshme për çështjen, te caktojë ekspert apo te kerkoje perjashtimin e tyre , te kerkoje
perjashtimin e trupit gjykues, si dhe të ndërmarrin çdo veprim procedural gjyqësor të nevojshëm
për zgjidhjen e çështjeve në favorin tone, perfshi ketu dhe marreveshje per zgjidhjen jashtegjyqesisht
te cdo ceshtje gjyqesore si dhe te na perfaqesojne ne dhe ne mungesen tone. Gjithashtu av, ka të
drejtë të nënshkruajë aktet e nevojshme procedurale në këto procese në emrin tone. Perfaqesuesja
ka të drejtë të paraqese ankim kundra vendimeve te ndermjetme, perfundimtare, rekursi apo
kundërekursin në Gjykatën e Lartë si dhe te kete te drejten te paraqesin kerkese në Gjykatën
Kushtetuese, me te drejte nenshkrimi. Perfaqesuesja ka të drejtë të na përfaqësojë dhe mbrojnë edhe
në Gjykatën e Apelit, Gjykatën e Lartë apo në Gjykatën Kushtetuese, porse dhe ne rast se ceshtja
kthehet per rigjykim prej cilesdo shkalles te gjyqesorit. Avokatja Zj. Denisa Daka, ka të drejtë të
mbledhe dhe të kerkoje te dhëna, të kërkojë marrjen e provave, edhe pranë të tretëve, apo organeve
të ndryshme të administratës publike për këto çështje, duke paraqitur kerkesa ne emrin tim.
Perfaqesuesja ka të drejtë të ndërmarre edhe veprime të tjera ligjore, që ajo do ti cmoje të
domosdoshme për zgjidhjen e cdo çështjeve në favorin tone. Perfaqesuesja ka te drejte te ndjekoje dhe
procedurat permbarimore ne favorin tone, duke nenshkruar kerkemat e duhura prane zyres
permbarimore perkatese, dhe nese do te jete nevoja avokatja ka te drejte dhe te kundërshtojë
veprimet e permbaruesit gjyqësor ne rruge administrative dhe gjyqesore ne te gjitha shkallet e
gjykimit me te gjitha te drejtat procedurale qe i jep ligji procedural civil ne fuqi. Avokatja ka te
drejte te na perfaqesojë edhe ne ndjekjen e cdo ceshtje penale qe mund te filloje nga ana jone, duke e

ndjekur ceshtjen ne organet perkatese,prane organit te akuzes dhe prane gjykatave te te gjitha niveleve duke patur cdo te drejte procedurale sipas ligjit penal procedural, deri ne perfundim te cdo ceshtje perkatese.Cdo veprim i kryer nga perfaqesuesit e mij do të konsiderohet si i kryer nga une porositësi.

Kjo prokure u hartua ne 10 kopje me fuqi te barabarte ligjore dhe pasi u lexua me ze te larte u gjet sipas vullnetit te lire dhe te plote te te perfaqesuarit u nenshkrua prej tij para meje Noteres dhe une duke e gjetur ate ne perputhje me ligjin e vertetoj.

I PERFAQESUARI
Erjon XHEMALI





V E N D I M

PER REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Sot, me date 18/10/2012 une gjyqtarja Fatime Deçolli, e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane mora ne shqyrtim kerkesen e kerkuesit, **Shoqeria A.C.R.E.E. shpk, e perfaqesuar nga administratori i saj z. Erjon Xhemali**, i cili kerkon te regjistroje si person juridik **QENDREN "PER ZHVILLIM DHE INTEGRIM PER SHQIPERINE" (ZHISH)**,

K O N S T A T O V A :

Kerkuesi, kerkon te regjistroje si person juridik **"QENDREN PER ZHVILLIM DHE INTEGRIM PER SHQIPERINE" (ZHISH)**, e cila do te kete seline ne Tirane, Shqiperi, Rr."Durrësit", Kompleksi Karavani, Kulla II-te, Ap.10.

QENDRA "ZHVILLIM DHE INTEGRIM PER SHQIPERINE" (ZHISH)

do te jete nje Qender e pavarur, kerkimore, studimore, këshilluese dhe zbatuese.

Qendra do te themelohet me qellimin e meposhtem :

- Te promovojë politikat europiane, referuar zgjerimit te Bashkimit European
- Te mundesoje pershtatshmerine e prospektives europiane per zhvillimin e hapesirave ne vend.
- Te jape ndihmen e saj ne zgjidhjen e problemeve ekonomike dhe kombinimin e nevojave ne rritje per nje menaxhim te qendrueshem, duke bere Studime, kërkime, konsulenca, trajnime, ekspertiza dhe aplikime projektesh, etj.

Objekti i veprimtarise se saj do te jete ne keto fusha :

- Promovimi i politikave europiane referuar:
 - a. zgjerimit te bashkimit european
 - b. politikave ne mbeshtetje te komunitetit
 - c. pershtatshmeria me prospektiven europiane per zhvillimin e hapesirave.
- promovimi dhe mbeshtetja e partneriteteve publike dhe private, me inisiativat Euro PPP dhe MasterPPPlan, referuar:
 - a. zhvillimit rajonal dhe urban
 - b. trafikut dhe transportimit
 - c. mjedisit
 - d. turizmit
 - e. sherbimeve baze
 - f. ndertimeve publike
 - g. rikonstruksioneve
 - h. trashegimise kulturore



procese vendimtare.

Kohezgjatja e saj eshte per nje periudhe kohe te pacaktuar.
Anetaret e Bordit te Pare te Drejtoreve, te emeruar sipas ketij akt themelimi jane:

1. Mariel Xhemali
2. Andi Xhemali
3. Oltion Zeneli
4. Kastriot Zeraj
5. Peter Histof

Drejtores ekzekutive eshte Z.Erjon Xhemali.

Kerkesa e tij eshte e drejte dhe si e tille ajo duhet te pranohet

PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit 7580, date 29.07.1994 nenet 39-53 , ligjit 8788, dt. 07.05.2001 "Per organizatat Jofitimprurese" dhe si dhe te ligjit 8789, dt. 7.05.2001 "Per regjistrimin e organizatave jofitimprurese"

V E N D O S A :

Regjistrimin si person juridik te **"QENDRES PER ZHVILLIM DHE INTEGRIM PER SHQIPERINE" (ZHISH)**, e cila do te kete seline ne Tirane, Shqiperi, Rr."Duresit", Kompleksi Karavani, Kulla II-te, Ap.10.

QENDRA "ZHVILLIM DHE INTEGRIM PER SHQIPERINE" (ZHISH)
do te jete nje Qender e pavarur, kerkimore, studimore, keshilluese dhe zbatuese.
Qendra do te themelohet me qellimin e meposhtem :
-Te promovojte politikat europiane, referuar zgjerimit te Bashkimit European
-Te mundesoje pershtatshmerine e prospektives europiane per zhvillimin e hapesirave ne vend.
- Te jape ndihmen e saj ne zgjidhjen e problemeve ekonomike dhe kombinimin e nevojave ne rritje per nje menaxhim te qendrueshem, duke bere Studime, kerkime, konsulenca, trajnime, ekspertiza dhe aplikime projektesh, etj.

Objekti i veprimtarise se saj do te jete ne keto fusha :

- Promovimi i politikave europiane referuar:
 - a. zgjerimit te bashkimit european
 - b. politikave ne mbeshtetje te komunitetit
 - c. pershtatshmeria me prospektiven europiane per zhvillimin e hapesirave.
- promovimi dhe mbeshtetja e partneriteteve publike dhe private, me iniciativat Euro PPP dhe Master PPP plan, referuar:
 - a. zhvillimit rajonal dhe urban
 - b. trafikut dhe transportimit
 - c. mjedisit
 - d. turizmit
 - e. sherbimeve baze



Per keto arsye Qendra do te ofroje sherbimet e meposhteme:

- lobim dhe perfaqesim i interesave te komunitetit
- hulumtim dhe standartizim te procedurave te partneriteteve publike e private (PPP)
- prezantim te projekteve perpara Insitucioneve politike dhe atyre ekonomike.
- mbeshtetje ne prezantim dhe vleresim projektesh.
- trajnim lidhur me ofrimin e sherbimeve per ceshtje qe kane te bejne me partneritetet publike dhe private ne Europe (PPP).
- planifikim strategjik te bashkepunimeve dhe krijim te konsorciumeve..
- menaxhim i konsensusit dhe konfliktit ne partneritetet publike, private (PPP), realizimi i negociatave.
- menaxhim te projekteve PPP, lidhur me infrastrukturen.
- organizim i eventeve, me qellim realizimin e lidhjeve dhe transferimin e Know-how.
- zhvillimi i sherbimeve per PPP ne lidhje me zhvillimin rajonal.
- Zhvillim i sherbimeve lidhur me energjine.
- Zhvillim i sherbimeve lidhur me ceshtjet e ambientit.
- Zhvillim I sherbimeve lidhur me ceshtjet e trashegimise kulturore
- Zhvillim I sherbimeve lidhur me ceshtjet e sherbimeve baze, ndertimeve publike, rikonstruksioneve, dhe turizmit, si dhe zhvillimit rajonal e urban.

Grupet e synuar per ofrimin e sherbimeve, do te jene:


- bizneset dhe industrite
- insitucionet shkencore dhe ato te kerkimit
- insitucionet kombetare dhe ato nderkombetare
- Insitucionet kombetare, rajonale si dhe ato lokale
- organizatat jo-fitimprures dhe jo-qeveritare (NGO-S)
- personat fizike

ZHISH, eshte nje organizate e cila ne misionin e saj, ka:

- menaxhimin e njohurive
- menaxhimin e projekteve
- menaxhimin e proceseve

Metodat per implementimin e nje procesi te tille, do te jene:

- vizioni i qarte dhe orientimi, per te kryer e pershtatur procese te targeteve te perbashket, ne favor te komunitetit.
- bashkepunimi dhe aftesia per te zgjidhur situata konfliktuale, dhe besimi i ndersjelle e fryma e ekipit.
- fryma demokratike dhe menaxhimi i aktoreve dhe pjesemarresve, mbeshtetja e ideve te reja, si dhe integrimi i burimeve njerezore.
- shperblimi per angazhimin e aktoreve dhe pjesemarresve si dhe tolerance kundrejt gabimeve ne proceset e veshtira.
- aftesia per (vete) observimin dhe parashikimin (mirefunksionimet e sistemeve te komunikimit dhe informacionit-permbledhje e shpejte dhe e detajuar e efektit te



h. ndertimeve publike
g. rikonstrukcioneve
h. trashegimise kulturore

Per keto arsye Qendra do te ofroje sherbimet e meposhteme:

- lobim dhe perfaqesim i interesave te komunitetit
- hulumtim dhe standartizim te procedurave te partneriteteve publike e private (PPP)
- prezantim te projekteve perpara Insitucioneve politike dhe atyre ekonomike.
- mbeshtetje ne prezantim dhe vleresim projektesh.
- trajnim lidhur me ofrimin e sherbimeve per ceshtje qe kane te bejne me partneritetet publike dhe private ne Europe (PPP).
- planifikim strategjik te bashkepunimeve dhe krijim te konsorciumeve..
- menaxhim i konsensusit dhe konfliktit ne partneritetet publike, private (PPP), realizimi i negociatave.
- menaxhim te projekteve PPP, lidhur me infrastrukturen.
- organizim i eventeve, me qellim realizimin e lidhjeve dhe transferimin e Know-how.
- zhvillimi i sherbimeve per PPP ne lidhje me zhvillimin rajonal.
- Zhvillim i sherbimeve lidhur me energjine.
- Zhvillim i sherbimeve lidhur me ceshtjet e ambientit.
- Zhvillim I sherbimeve lidhur me ceshtjet e trashegimise kulturore
- Zhvillim I sherbimeve lidhur me ceshtjet e sherbimeve baze, ndertimeve publike, rikonstrukcioneve, dhe turizmit, si dhe zhvillimit rajonal e urban.

Grupet e synuar per ofrimin e sherbimeve, do te jene:

- bizneset dhe industrite
- insitucionet shkencore dhe ato te kerkimit
- insitucionet kombetare dhe ato nderkombetare
- Insitucionet kombetare, rajonale si dhe ato lokale
- organizatat jo-fitimprures dhe jo-qeveritare (NGO-S)
- personat fizike

ZHISH, eshte nje organizate e cila ne misionin e saj, ka:

- menaxhimin e njohurive
- menaxhimin e projekteve
- menaxhimin e proceseve

Metodat per implementimin e nje procesi te tille, do te jene:

- vizioni i qarte dhe orientimi, per te kryer e pershtatur procese te targeteve te perbashket, ne favor te komunitetit.
- bashkepunimi dhe aftesia per te zgjidhur situata konfliktuale, dhe besimi i ndersjelle e fryma e ekipit.
- fryma demokratike dhe menaxhimi i aktoreve dhe pjesemarresve, mbeshtetja e ideve te reja, si dhe integrimi i burimeve njerezore.
- shperblimi per angazhimin e aktoreve dhe pjesemarresve si dhe tolerance kundrejt



gabimeve në proceset e veshtira.

-aftësia për (vete) observimin dhe parashikimin (mirefunksionimet e sistemeve të komunikimit dhe informacionit-permbledhje e shpejte dhe e detajuar e efektit të proceseve vendimtare.

T Kohezgjatja e saj është për një periudhë kohe të pacaktuar.

Anëtarët e Bordit të Për të Drejtoreve, të emëruar sipas këtij akt themelimi janë:

1. Mariel Xhemali
2. Andi Xhemali
3. Oltion Zeneli
4. Kastriot Zeraj
5. Peter Histof

Drejtor Ekzekutive është Z.Erjon Xhemali.

Kunder këtij vendimi lejohet ankimi sipas ligjit .

G J Y Q T A R E

FATIME DEÇOLLI





REPUBLIKA E SHQIPERISE



firmë/Signature

mbiemri/surname

Daka

emri/given name

Denisa

shetësi/nationality

Shqiptare/Albanian

vendndryshje/place of birth

Tirane

data/initial date of birth

02-07-1968

data e lëshimit/date of issue

24-03-2010

autoriteti i shprehur/authority

MB

nr. i caktimit/identification no.

028667748

gjendja

F

data e skadencës/date of expiry

23-03-2020

nr. personal/personal no.

G85702201G





REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMUNA ÇAKRAN

VENDIM
NR.57 DATE 10.12.2012

“Per pjesmarrjen e Komunes Cakran, si aksioner, ne themelimin e Shoqerise
“Gurezeze” SHA .

Mbeshtetur ne Ligjin Nr.8652 dat 31.07.2000”Per organizimin dhe funksionimin e
qeverisjes vendore”, ndryshuar me ligjin Nr.9208 date 18.03.2004, Neni 8, si dhe
ligji Nr.9901 date 14.04.2008” Per tregtarët dhe shoqerit tregtar”, Keshilli I
Komunes se Cakrani,

VENDOSI

1.Komuna Cakran,do te jete aksionere me 5% te kapitalit te Shoqeris “Gurezeza”
SHA, me aksioner te tjere, persona fizik e juridik me 95% te kapitalit te kesaj
shoqerie.

2.Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Sektori I Menaxhimit te Burimeve
Njerezore , Zyra Juridike.

Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes

U shpall sot me date 10.12.2012

SEKRETARI

Arsen Beshaj



KRYETARI

Adriatik Bregasi



VENDIM

I ORTAKEVE TE SHOQËRISË "CAKRAN 2012 sh.p.k.

Ne Tirane, sot me date 18.12.2012, ne Tirane, u mbajt mbledhja e ortakeve te shoqërisë "CAKRAN 2012" sh.p.k., shoqëri e themeluar dhe qe ushtron aktivitetin e saj sipas legjislacionit shqiptar, regjistruar ne Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare te Regjistrimit, mbajtëse e NUIS L22407018U

Jane te pranishem ne mbledhje:

Xhezmi VEIZAJ zoterues i 17 kuotave, me vlere te pergjithshme 17.000 Leke, qe perbejne 17% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Kastriot ZERAJ zoterues i 83 kuotave, me vlere te pergjithshme 83.000 Leke, qe perbejne 83% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Ortaket e shoqërisë mblidhen për te diskutuar mbi rendin e dites si me poshtë:

Rendi i ditës:

Shoqeria "Cakran 2012", shpk, te hyje si aksionere ne Shoqerine "Gurezeze" sha, me 90% te vleres se aksioneve ne kapitalin themeltar te Shoqerise, ne vleren 1.800.000 leke (nje milion e teteqind mije leke),

Pas diskutimit ne lidhje me çështjen e rendit te ditës, ortaket e shoqerise unanimisht,

VENDOSEN:

1- Shoqeria "Cakran 2012", shpk, te hyje si aksionere ne Shoqerine "Gurezeze" sha, me 90% te vleres se aksioneve ne kapitalin themeltar te Shoqerise, ne vleren 1.800.000 leke (nje milion e teteqind mije leke).

Pasi nuk kishte çështje te tjera për tu diskutuar mbledhja deklarohet e mbyllur.

ORTAKET E SHOQERISE "CAKRAN" sh.p.k.

Xhezmi VEIZAJ

Xhezmi Veizaj

Kastriot ZERAJ

Perfaqesuar nga Z. Erjon Xhemali

Erjon Xhemali

Shoqëria "CAKRAN 2012" shpk
Kompleksi karavan
Laorak - Tirane
0685424135279



REPUBLIKA E SHQIPËRIË



firmësignatura

mbiemri/surname

Korçari

emëligjen name

Vladimir

shqetesshationality

Shqiptare/Albanian

vendindalplace of birth

Cakran, Fier

datelindadate of birth

28-11-1959

data e leshmidate of issue

19-05-2009

autoriteti leshues/authority

MB

nr. leshmitomissin no

D25661239

gjiniasex

M

data e skadimitdate of expiry

18-05-2019

nr. personalpersonal no.

F91128016H



UNIONE EUROPEA

REPUBBLICA ITALIANA



PASSAPORTO



SCADE IL 25/02/2013



AO3239978



IPES SPA - OFFINA CV - ROMA

REPUBBLICA ITALIANA



COMUNE DI

FOGGIARONSI (SI)

CARTA D'IDENTITÀ

N° AO3239978

DI

XHEMALI
ERTON

*Appuntati: Senoo che
Hche.*

5



PERU MINISTRO
INDUSTRIAS

[illegible]

AA2534233

A black and white portrait of a man with a mustache, identified as the author. He is looking directly at the camera with a neutral expression. The image is grainy and has a high-contrast, somewhat somber tone.



28 MAR/MAR 2018

Alfred; Anna; Alice



Firma del titolare  26/02/2008
PUCCIBONSI

26/02/2008

d'ordine del Sindaco
IL FUNZIONARIO INCARICATO
CAPIANO COORDINATORE

MARINO CORDARO

Dir. Car. 10,32

0.26

Semi particolari

366656402

PASAPORTË

REPUBLICA E SHQIPËRISË

tipi/type

kodivcode

nr. pasaportės/pasaport no.

P

ALB

BG6656402

mbiemrisurname

Zeraj

2 emrügiven name

Kastriot

3 sheetasia/nationality

Shqiptare/Albanian

4 date[and]a/date of birth

15-05-1978

6 vendlindja/place of birth

Vlore, Vlore

7 data: c(lshimio/date of issue)

27-12-2010

10 autoriteti lëshues/authority

MB

5 g/ma/sex

M


8 data e skadimit/date of expiry

26-12-2020

11 nr. personal/personal no.

H80515257B

P<ALBZERAJ<<KASTRIOT<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<
BG66564024ALB7805156M2012261H80515257B<<<<98



This passport is valid for all countries unless otherwise endorsed (subject to any visa or other requirements of countries to be visited).

Co passeport est valable pour tous les pays, sauf indication contraire.
Il n'autorise d'ailleurs en aucun cas l'entrée sur le territoire d'un pays.
1818 001 4 Transmision de 36 181801

(Signature of bearer - Signature du titulaire)

U
A
N
A
D

18055566

Type	Country	Pays	emetteur	Passport No. N° de passeport
P	CAN			QB749665

Sumame/Nom	XHEMALI
Given names/Prénoms	MARIEL

Nationality/Nationality

CANADIAN/CANADIENNE

Date of birth/Date de naissance

73 CREDIT / CREDIT 73

07 02 1136 / 1136 02

100% Satisfaction Guarantee

Issuing Authority/Autorité de c

SCARBOROUGH

11

12 x 2 1/2

5

[illegible][illegible]

